

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI EKONOMIK



EDONA SEKIRACA IDRIZAJ

**VLERËSIMI I DEFICITIT TË LLOGARISË  
RRJEDHËSE TË BILANCIT TË PAGESAVE  
TË KOSOVËS**

**PUNIM I DOKTORATËS**

Prishtinë, 2023

UNIVERSITY OF PRISHTINA

FACULTY OF ECONOMICS



EDONA SEKIRACA IDRIZAJ

**ASSESSMENT OF CURRENT ACCOUNT OF  
KOSOVO'S BALANCE OF PAYMENTS**

**DOCTORAL THESIS**

Pristina, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI EKONOMIK



EDONA SEKIRACA IDRIZAJ

**VLERËSIMI I DEFICITIT TË LLOGARISË  
RRJEDHËSE TË BILANCIT TË PAGESAVE  
TË KOSOVËS**

**PUNIM I DOKTORATËS**

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Prishtinë, 2023

## ABSTRAKTI

Shumica e shteteve në zhvillim duke përfshirë edhe Kosovën, historikisht janë përballur me deficit të llogarisë rrjedhëse, të cilat në afat të gjatë mund të ngritin problemin e qëndrueshmërisë së deficitit të llogarisë rrjedhëse. Nëse analizohen statistikave të bilancit të pagesave të Kosovës prej kur ekziston historia e këtyre statistikave shihet se Kosova është duke u përballur me deficit të llogarisë rrjedhëse, i cili shumë lehtë mund të kuptohet se rrjedh nga struktura e ndërtimit të llogarisë rrjedhëse. Rrjedhimisht, ky punim synon të analizoj qëndrueshmërinë e deficitit të llogarisë rrjedhëse të Bilancit të Pagesave të Kosovës duke përdorur modelin strukturor të llogarisë rrjedhëse.

Problemet e deficitit të llogarisë rrjedhëse të Kosovës, sikur edhe në shumë vende tjera në zhvillim, konsiderohen strukturore pasi deficieti shkaktohet nga mos bilanci në tregtinë ndërkombëtare ku proporcioni i mallrave të importuar në krahasim me mallrat e eksportuar në raport me GDP është shumë i lartë. Në rastin e Kosovës ky disbalancim i madh ka qar në deficit të vazhdueshëm të llogarisë rrjedhëse, i cili në afate të gjatë mund të jetë i rrezikshëm në kontekstin e qëndrueshmërisë për shkak të mangësive strukturore në tregtinë dhe konkurrueshmërinë ndërkombëtare. Qëndrueshmëria e deficitit të llogarisë rrjedhëse nënkupton se sa gjatë një vend mund të ketë deficit të llogarisë rrjedhëse e të mos zhytet në krizë financiare dhe ekonomike ose sa gjatë deficieti do të jetë i qëndrueshëm pa hyrë në krizë financiare.

Punimi ka tentuar të gjej lidhjen në mes të deficieti të llogarisë rrjedhëse dhe faktorëve përcaktues të deficitit të llogarisë rrjedhëse në Kosovë. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për ekonominë të kuptohen faktorët që ndikojnë bilancin e llogarisë rrjedhëse, sepse kjo krijon iden e qartë se çfarë hapash duhet ndërmarr për një strategji efektive të vendimmarrjes. Duke përdorur modelin FMOLS dhe DOLS në serinë kohore T1 2010-T4 2020 të faktorëve përcaktues të deficieti të llogarisë rrjedhëse, është analizuar marrëdhënia afatgjatë në mes të variablave, përfshirë shenjën dhe magnitudën e lidhjes së tyre. Rezultatet e modelit kanë treguar harmoni me pritjet teorike për të gjitha variablat përjashtuar asetet e jashtme net dhe kursin real efektiv të këmbimit, të cilat besojmë se kanë treguar mospërputhje me literaturën për shkak të karakteristikave të ekonomisë së Kosovës. Më tej, nga rezultatet e modelit është konfirmuar se ekziston një lidhje e drejtë në mes

të llogarisë rrjedhëse dhe investimeve të huaja direkte, bilancit fiskal, normës reale efektive të këmbimit, remitancave dhe rritjes ekonomike. Ndërsa lidhje e zhdrejtë ekziston në mes të llogarisë rrjedhëse dhe aseteve të jashteme net, hapjes tregtare dhe bilancit tregtar.

Ndërsa, sa i përket nivelit të qëndrueshmërisë së deficitit të llogarisë rrjedhëse, duke përfshirë të gjitha variablat e modelit sipas çasjes strukturore të llogarisë rrjedhëse, norma e qëndrueshme e llogarisë rrjedhëse ka rezultuar të jetë 3.9%, e cila është shumë më e ulët se niveli aktual i llogarisë rrjedhëse prej 8 përqind (mesatarja gjatë periudhës 2010-2020). Ndërsa, sipas çasjes MFR (Milesi-Ferreti dhe Razin) rezultati i qëndrueshëm i deficitit të llogarisë rrjedhëse është 0.88%, e cila krahasuar me rezultatin ekzistues të deficitit të llogarisë rrjedhëse prej 8%, përbën diferencë shumë të madhe. Edhe sipas skenarit të dytë, i cili merr parasysh përfshirjen e investimeve direkte në kalkulimin e qëndrueshmërisë së deficitit të llogarisë rrjedhëse, fitojmë rezultatin prej 4.6%, i cili është shumë më i ulët se deficit aktual.

**Fjalët kyçe:** deficioni i llogarisë rrjedhëse, qëndrueshmëria e llogarisë rrjedhëse, bilanci tregtar.

## **ABSTRACT**

Most developing countries, including Kosovo, historically have faced current account deficits, which in the long term can raise sustainability concerns regarding the current account deficit. Analyzing Kosovo's balance of payments statistics since the inception of these statistics, it can be seen that Kosovo is grappling with a current account deficit, which can easily be understood to stem from the structure of the current account balance. Consequently, this paper aims to analyze the sustainability of Kosovo's Balance of Payments current account deficit using the structural model of the current account.

The problems of Kosovo's current account deficit, as in many other developing countries, are considered structural since the deficit arises from an imbalance in international trade, where the proportion of imported goods compared to exported goods in relation to GDP is very high. In the case of Kosovo, this significant imbalance has led to a continuous current account deficit, which in the long term can be risky in terms of sustainability due to structural deficiencies in trade and international competitiveness. The sustainability of the current account deficit implies how long a

country can have a current account deficit without plunging into financial and economic crisis or how sustainable the deficit can be without entering into a financial crisis.

The paper attempts to find the relationship between the current account deficit and its determinants in Kosovo. It is crucial for the economy to understand the factors influencing the current account balance because this provides a clear idea of what steps should be taken for an effective decision-making strategy. By using the FMOLS and DOLS models on the time series T1 2010-T4 2020 of the determinants of the current account deficit, the long-term relationship between variables, including the sign and magnitude of their connection, has been analyzed. The model results have shown consistency with theoretical expectations for all variables except net foreign assets and the real effective exchange rate, which we believe have discrepancies due to the characteristics of Kosovo's economy. Furthermore, the results of the model confirm that there is a direct link between the current account and foreign direct investment, fiscal balance, real effective exchange rate, remittances, and economic growth. Meanwhile, an inverse relationship exists between the current account and net foreign assets, trade openness, and trade balance.

Regarding the level of sustainability of the current account deficit, including all the model variables according to the structural approach of the current account, the sustainable current account rate has resulted in 3.9%, which is much lower than the actual current account level of 8% (average during the 2010-2020 period). However, according to the MFR (Milesi-Ferretti and Razin) approach, the sustainable current account deficit is 0.88%, which is significantly lower compared to the existing current account deficit of 8%, presenting a considerable difference. Even under the second scenario, which considers including foreign direct investment in calculating the sustainability of the current account deficit, we obtain a result of 4.6%, which is much lower than the current deficit.

**Keywords:** current account deficit, current account sustainability, trade balance.